



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-60/01-1256/17 datë:23.01.2017



Npi - 01/20 datë: 01.02.2017

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e parë të rregullt për vitin 2017, të mbajtur më 01.02.2017, pas diskutimeve lidhur me propozimin e deputetit z.Isak Musliu, unanimisht votoi këtë:

D E K L A R A T Ë

1. Të lirohet menjëherë nga të gjitha akuzat e montuara nga Serbia mbi bazën e të cilave shteti mik Franca, ka ndaluar ish Kryeministrin dhe kryetarin e AAK-së, z.Ramush Hajredinaj.
2. Kuvendi i Komunës së Shtimes, kërkon nga Qeveria e Kosovës që ta kushtëzojë vazhdimin e dialogut me lirimin nga fletarrestet nga Serbia të ish Kryeministrit Ramush Hajredinaj si dhe të gjithë ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
3. Kërkojmë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që përmes mekanizmave të vet të bëjë presion dhe të kërkojë nga shtetet mike që të mos zbatojnë asnjë urdhër arresti nga Serbia me qëllim të njollosjes së Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe personaliteteve të saj.



Kryesuesi i Kuvendit
Rrahman Jakupi